

Banka e Shqipërisë

**INSTRUMENTET E
POLITIKËS MONETARE**

Mars 2002

INSTRUMENTAT PËR ZBATIMIN E POLITIKËS MONETARE

Banka e Shqipërisë është banka e qendrore e vendit. Nëpërmjet politikave të saj dhe në funksion të detyrave që i përcakton ligji “Për Bankën e Shqipërisë” ajo bën të gjitha përpjekjet për arritjen e objektivit themelor: arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve ose siç jemi mësuar të gjithë ta dëgjojmë, të kontrollojë nivelin e inflacionit. Përpara se të hartojë politikat që duhet të ndjekë Banka e Shqipërisë përkufizon objektivat finalë, objektivat e ndërmjetëm dhe instrumentet me të cilat do të veprojë për arritjen e objektivave.

Ç’kuptojmë me instrumente të politikës monetare?



Fig. 1 Instrumentet janë të shumëllojshëm

Instrumentet përfaqësojnë ato mjete apo mekanizma me anë të të cilëve Banka e Shqipërisë ndikon në sjelljen në treg të bankave të nivelit të dytë, për të siguruar që kushtet e tregut dhe niveli i parasë në ekonomi të jenë në përputhje me objektivin final të saj.

Banka e Shqipërisë, për zbatimin e politikës së saj hyn në transaksione vetëm me bankat e nivelit të dytë.




Fig. 2 Banka e Shqipërisë me bankat e nivelit të dytë

Për zbatimin e politikës së saj monetare një bankë qendrore mund të veprojë në dy mënyra: me instrumente direkte, ose me instrumente indirekte.

Ku ndryshojnë instrumentat direkte me ato indirekte të politikës monetare?

Të veprosh me instrumente direkte do të thotë të përdorësh autoritetin rregullator.

Një bankë qendrore, nëpërmjet rregulloreve e udhëzimeve të saj për bankat e nivelit të dytë, përcakton apo vendos kufizime në nivelin e sasisë dhe të çmimit të agregatëve monetarë.

Kështu p.sh. ajo vendos për bankat e nivelit të dytë një kufi, shumë të caktuar parash për t'iu dhënë kredi publikut. Bankat duhet të respektojnë dhe të mos e tejkalojnë asnjëherë këtë kufi krediti. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë përcakton çmimin apo normën e interesit që bankat e nivelit të dytë duhet t'u paguajnë klientëve që depozitojnë pará në to. Këto dy mënyra përfaqësojnë ndërhyrjen direkte të bankës qendrore.

Të veprosh me instrumente indirekte do të thotë që vetë banka qendrore të ndërhyjë në tregun e parasë. Kur ajo me anë të operacioneve të ndryshme monetare ndërhy në treg për të ndikuar në normat e interesit, apo për të rritur ose zvogëluar nivelin e likuiditetit¹ në sistemin bankar, themi se vepron në mënyrë indirekte, pasi janë veprimet e saj në treg që ndryshojnë kushtet e tij dhe jo autoriteti i saj.

Aktualisht, Banka e Shqipërisë operon vetem me instrumentet indirekte të politikës monetare.

¹ Me termin “likuiditete”, në kontekstin e kësaj broshure kuptojmë rezervat në para të bankave të nivelit të dytë që përdoren për kryerjen e pagesave dhe transaksioneve të tjera të tyre.

Instrumentet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë janë:

- 1. Operacionet e tregut të hapur,**
 - Operacionet e kthyeshme,
 - Transaksionet e shit/blerjeve me të drejta të plota,
 - Operacionet në valutë (këto mund të kuptohen si pjesë e shitblerjeve me të drejta të plota).
- 2. Instrumentet mbështetës**
 - Kredia lombard
 - Kredia njëditore
 - Depozita njëditore
- 3. Rezerva e detyrueshme**

1. ÇFARË JANË OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR?



Fig. 3 Operacionet në treg

Operacionet e tregut të hapur përfaqësojnë blerjen apo shitjen në treg të letrave me vlerë nga ana e Bankës së Shqipërisë. Operacionet e tregut të hapur mund të jenë në formën e *transaksioneve të kthyeshme*, që përfshijnë

marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve dhe në formën e transaksioneve me të drejta të plota, që përfshijnë operacionet e shitblerjeve të letrave me vlerë apo valutave të huaja.

Është e rëndësishme të thuhet që, operacionet e tregut të hapur ndërmerren nga Banka e Shqipërisë, e cila vendos gjithashtu, për instrumentet që do të përdorë dhe kushtet e ekzekutimit të tyre.

Operacionet e tregut të hapur luajnë një rol të rëndësishëm në politikën monetare të Bankës së Shqipërisë dhe kanë për qëllim:

- të rregullojnë normën e interesit në treg, duke e mbajtur atë në një nivel të tillë që nga njëra anë të mos krijohen situata problematike likuiditeti për bankat dhe nga ana tjetër të përçohen në treg veprimet e Bankës së Shqipërisë;
- të administrojnë situatat e likuiditetit, duke shtuar apo pakësuar likuiditetin në treg, duke ndërhyrë me operacionet saj për blerjen apo shitjen e letrave me vlerë të qeverisë²;
- t'u japin sinjale bankave në lidhje me politikën monetare të Bankës së Shqipërisë që do të vijojë.

² Banka e Shqipërisë, nëpërmjet operacioneve të saj, blen ose shet vetëm bono thesari, që janë letra me vlerë afatshkurtra të emetuara nga qeveria për të mundësuar kryerjen e shpenzimeve publike.

1.1. TRANSAKSIONET E KTHYESHME.

Këto transaksione quhen të tilla pasi ato përfaqësojnë transaksione që përbëhen nga dy hapa: hapi i parë përfaqësohet nga shitja/blerja e letrës me vlerë dhe hapi i dytë apo i kthimit, përfaqësohet nga riblerja/rishitja prapë e letrës me vlerë.

⇒ **Marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve.**



Fig. 4 Për marrëveshjet e riblerjes negociohet

- **Të përgjithshme**

Marrëveshja e riblerjes nënkupton një marrëveshje, me anë të së cilës Banka e Shqipërisë u shet letra me vlerë bankave të nivelit të dytë dhe premtion t'i riblejë ato në të ardhmen, sipas afateve dhe kushteve të rëna dakord. Ky është një instrument që përdoret për të pakësuar përkohësisht likuiditetin në sistemin bankar ose ndryshe për të zvogëluar përkohësisht aftësinë e bankave për të dhënë kredi, apo për të ulur paranë në qarkullim. Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes nënkupton një marrëveshje, me anë të së cilës Banka e Shqipërisë blen letra me vlerë nga bankat e

nivelit të dytë dhe premtion t'i rishesë ato në të ardhmen, sipas afateve dhe kushteve të rëna dakord paraprakisht. Ky është një instrument që përdoret për të shtuar përkohësisht likuiditetin në sistemin bankar, ose për të rritur përkohësisht aftësinë e bankave për të rritur kredidhënien apo për të rritur nivelin e parave në duart e publikut. Marrëveshjet e anasjellta të riblerjeve, që zhvillohen nëpërmjet ankandeve për blerje, konsiderohen si hua të garantuara, ose thënë ndryshe hua të kolateralizuara. Në këtë rast, vlera e garancisë është 115 për qind, pra 15 për qind më shumë se shuma e futur në veprim.

Letrat me vlerë, objekt i këtyre transaksioneve, janë të blera më parë nga Banka e Shqipërisë apo bankat e nivelit të dytë në tregun primar apo sekondar³. Pra, për të hyrë në këto transaksione, si Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë duhet të kenë paraprakisht në portofolin e tyre letra me vlerë (bono thesari).

- **Maturimi**

Nisur nga afati i maturimit dallojmë katër tipe të marrëveshjeve të riblerjeve:

- ***me afat maturimi një ditë.***
- ***me afat maturimi shtatë ditë.***
- ***me afat maturimi një muaj.***
- ***me afat maturimi tre muaj.***

³ Tregu primar përfaqëson tregun në të cilin letrat me vlerë ofrohen për tu shitur për herë të parë nga emetuesi. Tregu sekondar përfaqëson tregun në të cilin letrat me vlerë, të tregtuara më parë në tregun primar, ofrohen për tu shitur apo blerë jo më nga emetuesi i tyre por nga blerësit e mëparshëm.

- **Shuma për pjesëmarrje**

Që një bankë të marrë pjesë në ankandin e marrëveshjeve të riblerjeve, kërkesa e saj duhet të jetë minimalisht 5 (pesë) milionë lekë, dhe mbi këtë shumë mund të rritet me shumëfisha prej 100 mijë lekësh.

⇒ **Ankand për shitje** (marrëveshje riblerje). Në këtë ankand, Banka e Shqipërisë shet letrat me vlerë dhe premtion t'i riblejë ato në një datë të caktuar në të ardhmen.

⇒ **Ankand për blerje** (marrëveshje të anasjellta riblerje). Në këtë ankand, Banka e Shqipërisë blen letrat me vlerë dhe premtion t'i rishesë ato në një datë të caktuar në të ardhmen.

⇒ Në **ankandet me shumë çmime**, Banka e Shqipërisë shpall në njoftimin për ankand shumë e gatshme për t'u blerë. Kërkesat e bankave plotësohen sipas shumës së paraqitur në kërkesën e tyre për të marrë pjesë në ankand, derisa të arrihet shuma e shpallur nga Banka e Shqipërisë. Fillimisht, plotësohen kërkesat e atyre bankave norma e interesit të cilave nuk është më e lartë, në ankandet për shitje (më e ulët në ankande për blerje), nga norma e interesit të shpallur në njoftimin e Bankës së Shqipërisë.

Shembull. Shpërndarja në ankandet me shumë çmime.

Supozojme se kemi 5 banka që i janë përgjigjur ftesës së Bankës së Shqipërisë për të marrë pjesë në ankandin e rradhës të marrëveshjeve të anasjellta riblerjes. Ankandi është i tipit me shumë çmime, norma minimale e njoftuar e interesit të ankandit është 7 për qind dhe sasia e ofruar e likuiditetit nga Banka e Shqipërisë në këtë ankand është 12 miliardë lekë.

Pra, Banka e Shqipërisë blen bono thesari dhe ofron likuiditete në masën 12 miliardë lekë.

Bankat kanë paraqitur kërkesat e tyre, si më poshtë:

	Kërkesat e bankave				
	7.0%	7.10%	7.15%	7.24%	7.30%
Banka A	2	1			
Banka B		1	1.5		
Banka C			1.5		
Banka D				2	1
Banka E				1	1
Totali	2	2	3	3	2

Plotësimi i kërkesave bëhet duke u nisur nga norma më e lartë e interesit. Kështu, do të plotësohen fillimisht kërkesat e bankave me normë interesi 7.44%, më pas me normë 7.30%, 7.24%, 7.15% dhe 7.0%. Nëse sasia e ofruar në ankand nga Banka e Shqipërisë është më e vogël se sasia e kërkuar e likuiditetit nga bankat pjesëmarrëse, atëherë kërkesa me normën më të ulët të interesit nuk do të plotësohet tërësisht, por pjesërisht derisa të arrihet oferta e Bankës së Shqipërisë.

Në këtë rast shpërndarja bëhet si më poshtë:

Banka A	0.5 mld me 7.0% dhe 1 mld me 7.10%
Banka B	1 mld me 7.10% dhe 1.5 mld me 7.15%
Banka C	1.5 mld me 7.15%
Banka D	2 mld me 7.24%; 1 mld me 7.30% dhe 0.5 mld me 7.44%.
Banka E	1 mld me 7.24%; 1 mld me 7.3% dhe 1 mld me 7.44%.

⇒ Në **ankandet me çmim fiks**, Banka e Shqipërisë përcakton normën e interesit, e cila është e vetme. Kërkesat e bankave pjesëmarrëse plotësohen sipas shumave të përcaktuara nga vetë ato për të marrë pjesë në ankand, pasi norma e interesit nuk ndryshon. Në këtë lloj ankandi nuk ka kufizime në shumë.

Shembull. Shpërndarja në ankandet me çmim fiks.

Supozojmë se kemi 5 banka që i janë përgjigjur ftesës së Bankës së Shqipërisë për të marrë pjesë në ankandin e radhës të marrëveshjeve të riblerjes. Ankandi është i tipit me çmim fiks, norma e njoftuar e interesit të ankandit është 7 për qind.

Bankat kanë paraqitur kërkesat e tyre, si më poshtë:

Pjesëmarrësit	Kër Norma e ir
Banka A	
Banka B	
Banka C	2
Banka D	1
Banka E	
Totali	1

Plotësimi i kërkesave të bankave nga Banka e Shqipërisë bëhet për të gjithë shumën e kërkuar prej tyre. Në këtë rast shpërndarja bëhet si më poshtë:

Banka A	2 mld
Banka B	3 mld
Banka C	2.5 mld
Banka D	1.5 mld
Banka E	3 mld

- **Norma e interesit**

Norma fikse e interesit të riblerjes për ankandet standarde të marrëveshjeve të riblerjeve vendoset nga Banka e Shqipërisë. Kjo normë shërben si niveli më i lartë/më i ulët për ankandet me shumë çmime.

Në marrëveshjet e riblerjeve blihen dhe shiten letrat me vlerë të qeverisë me afat maturimi 3, 6 dhe 12 muaj.

- **Tipi i ankandit**

Ankandet për zhvillimin e marrëveshjeve të riblerjes mund të jenë:



Fig. 5 Po zhvillohet ankandi

⇒ **Ankand të tipit standard.** Këto ankande zhvillohen brenda ditës së nesërme nga momenti i njoftimit për ankandin e rradhës shtatëditor. Ankandet mbahen ditën e mërkurë të çdo jave.

⇒ **Ankand të shpejtë.** Ankandet e tipit të shpejtë janë të klasifikuar në dy nëntipe:

- **ankande të shpejta për marrëveshjet e riblerjeve me afat maturimi një ditë.** Këto ankande zhvillohen brenda dy orëve nga njoftimi për ankand njëditor.
- **ankande të shpejta për marrëveshjet e riblerjeve me afat maturimi një/tre muaj.** Këto ankande zhvillohen brenda katër orëve nga njoftimi për ankand një/tre mujor.

Ankandet standarde mbahen sipas kalendarit të përcaktuar paraprakisht në fillim të vitit kalendarik, ndërsa ankandet e tipit të shpejtë mbahen në mënyrë spontane, sa herë që lind nevoja e ndërhyrjes në treg nga ana e Bankës së Shqipërisë.

- Çfarë duhet të bëjë një bankë që të pranohet të marrë pjesë në ankandet e marrëveshjeve të riblerjeve?

Për të qenë të pranueshme si palë në marrëveshje riblerjeje, bankat e nivelit të dytë, në fillim të çdo viti kalendarik, duhet të nënshkruajnë një kontratë me afat njëvjeçar me Bankën e Shqipërisë, e cila i paraprin zbatimit të marrëveshjeve të riblerjeve që do të zhvillohen në vazhdim, nëpërmjet ankandeve.



Fig. 6 Nënshkrimi i marrëveshjeve të riblerjes

- Si funksionon ankandi për marrëveshjet e riblerjeve?

Banka e Shqipërisë, përpara organizimit të ankandit të marrëveshjeve të riblerjeve, njofton bankat e nivelit të dytë për tipin dhe kushtet e ankandit me SWIFT, teleks, REUTERS, faks ose shkresë zyrtare.

Në këtë njoftim (shkresë), ndër të tjera, bankat njoftohen për llojin e ankandit, datën dhe orën e ankandit, shumën e ofruar në ankand, normën e interesit, etj.

Nëse ankandi është i tipit standard ai zhvillohet periodikisht çdo javë, ditën e mërkurë në orën 14:00.




Fig.7 Respektimi i orareve të ankandeve

Kërkesat e bankave duhet të paraqiten në Bankën e Shqipërisë, ku zhvillohet ankandi, brenda orës 13:30 të ditës së ankandit.

Në ankandet me shumë çmime, kërkesat radhiten në mënyrë rritëse/zbritëse. Shpallen automatikisht fituese të gjitha kërkesat, nëse shuma e kërkuar nga bankat është më e vogël sesa shuma e shpallur nga Banka e Shqipërisë.

Nëse shuma e kërkuar nga bankat është më e lartë se shuma e ofruar nga Banka e Shqipërisë, atëherë Banka e Shqipërisë llogarit raportin midis sasisë së mbetur për t'u shpërndarë, me shumën e kërkesave të bankave, interesi i riblerjes së të cilave është i barabartë. Në bazë të këtij raporti bëhet më pas shpërndarja e sasisë së mbetur. Kjo mënyrë shpërndarje në gjuhën teknike njihet me termin *pro-rata*.

Shembull. Zbatimi i *pro rata-s*.

Supozojmë se kemi 5 banka që i janë përgjigjur ftesës së Bankës së Shqipërisë për të marrë pjesë në ankandin e rradhës për marrëveshje të anasjellta të riblerjes. Ankandi është i tipit me shumë çmime, norma minimale e njoftuar e interesit të ankandit është 7 për qind dhe sasia e ofruar e likuiditetit nga Banka e Shqipërisë në këtë ankand është 12 miliardë lekë.

Bankat kanë paraqitur kërkesat e tyre, si më poshtë:

	Kërkesat e bankave						
	7.0%	7.10%	7.15%	7.24%	7.30%	7.44%	Totali
Banka A	2	1					3
Banka B	1	1	0.5				2.5
Banka C			1	0.5			1.5
Banka D				2	1	0.5	3.5
Banka E				1	1	1	3
Totali	3	2	1.5	3.5	2	1.5	13.5

Plotësimi i kërkesave të bankave të nivelit të dytë për t'i shitur bono thesari Bankës së Shqipërisë bëhet duke u nisur nga norma më e lartë e interesit. Kështu, do të plotësohen fillimisht kërkesat e bankave me normë interesi 7.44%, më pas ato me normë 7.30%, 7.24%, 7.15% dhe 7.0%. Nëse sasia e ofruar në ankand nga Banka e Shqipërisë është më e vogël se sasia e kërkuar nga bankat pjesëmarrëse, atëherë për bankat që ofrojnë norma të njëjta interesi, do të zbatohet mekanizmi *pro rata*, derisa të arrihet oferta e Bankës së Shqipërisë. Deri në normën e interesit 7.10%, shpërndarja bëhet siç është kërkuar nga bankat.

Problemi qëndron në rastin e normës së interesit 7%, ku për t'u plotësuar shuma e shpallur nga Banka e Shqipërisë duhen dhe 1.5 mld lekë, ndërkohë që kërkesa e përbashkët e bankave A dhe B është 3 mld lekë.

Për të zgjidhur shpërndarjen e fondeve midis bankave A dhe B zbatohet *pro rata*. Në rastin tonë sasia për t'u shpërndarë është 1.5 mld lekë, sasia e mbetur për t'u ofruar është 3 mld dhe nga raporti i të dyjave *pro rata* rezulton $(1.5/3) 0.5$.

Atëherë Bankës A i shpërndahen 1 mld lekë $(0.5 \times 2 \text{ mld. Lekë})$ dhe Bankës B 0.5 mld lekë $(0.5 \times 1 \text{ mld. lekë})$.

Në këtë rast, shpërndarja për të gjithë bankat pjesëmarrëse është:

Banka A	1 mld me 7.0% dhe 1 mld me 7.10%
Banka B	0.5 mld me 7.0%; 1 mld me 7.10% dhe 0.5 mld me 7.15%
Banka C	1 mld me 7.15% 0.5 mld me 7.24%.
Banka D	2 mld me 7.24%; 1 mld me 7.30% dhe 0.5 mld me 7.44%.
Banka E	1 mld me 7.24%; 1 mld me 7.3% dhe 1 mld me 7.44%.

Pas përfundimit dhe shpalljes së fituesve, komisioni i ankandit bën njoftimet përkatëse për rezultatet e ankandit, si për pjesëmarrësit ashtu dhe për administratorët e Bankës së Shqipërisë.

Njoftimi i pjesëmarrësve në ankand bëhet me SWIFT, teleks, REUTERS, faks ose shkresë zyrtare.




Fig. 8 Mjetet e komunikimit me bankat

Shembull: *Marrëveshjet e riblerjeve.*

Supozojmë se Banka e Shqipërisë fton bankat e nivelit të dytë të marrin pjesë në ankandin e rradhës për marrëveshjet e riblerjes me afat maturimi 7 ditë. Ankandi është standard dhe i tipit me shumë çmime. Shuma e ofruar në ankandin e marrëveshjeve të riblerjes është 12 mld lekë dhe norma e interesit të ankandit është 6.5%. Meqë ankandi është i tipit me shumë çmime, nga ankandi do të për zgjidhen fitues ata pjesëmarrës që kanë ofruar norma interesi më të ulëta se 6.5%.

Bankat që kanë fonde të lira në arkat e tyre dhe dëshirojnë të marrin pjesë në ankand dërgojnë në Bankën e Shqipërisë kërkesat e tyre si më poshtë:

Pjesëmarrësit	Shuma e kërkuar në mld në lekë	k
Banka A	0.285	
Banka B	0.600	
Banka C	0.250	
Banka D	12	
Banka E	0.470	
Totali	13.605	

Në Bankën e Shqipërisë zhvillohet ankandi dhe sipas procedurës së tij përzgjidhen fituesit. Shohim se të gjitha bankat kanë kërkuar të investojnë me norma interesi më të ulëta se norma e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Plotësohen fillimisht kërkesat e pjesëmarrësve me norma interesi më të ulëta (pra, nga më e ulëta tek më e larta) dhe kjo procedurë vazhdon deri sa të plotësohet shuma prej 12 mld lekë.

Gjithashtu, shohim se shuma e kërkuar nga bankat është më e lartë se shuma e ofruar nga Banka e Shqipërisë (12 mld lekë). Për bankën që ofron interes më të lartë zbatohet pro rata. Atëherë, plotësohen kërkesat e bankave E, A, C, B plotësisht dhe bankës D do t'i plotësohet kërkesa deri sa të arrihet në nivelin 12 mld. Shuma e katër bankave të para është 1.605 mld lekë dhe për t'u plotësuar gjithë sasia duhen ende 10.395 mld lekë. *Pro rata* e zbatuar në këtë rast është 86.6%(10.395mld/ 12.0 mld).

Për fituesit kemi:

Pjesëmarrësit	Shuma e pranuar në mld lekë	Norma e interesit në %
Banka E	0.470	6.00
Banka A	0.285	6.15
Banka C	0.250	6.20
Banka B	0.600	6.30
Banka D	10.395	6.49
Totali	12	

Siç është shkruar më lart marrëveshjet e riblerjeve realizohen me dy hapa. Në shembullin tonë kemi:

1- Bankat A, B, C, D dhe E marrin pjesë në ankand duke investuar/blerë letra me vlerë (bono thesari). Për investimin e bërë ato marrin interes sipas normës së interesit të përcaktuar nga vetë ato. Interesi llogaritet sipas formulës së interesit të thjeshtë:

$$\text{Shuma fillestare e investimit} \times \frac{\text{Norma e interesit}}{100} \times \frac{\text{Ditët në maturim}}{365}$$

Për çdo bankë kemi:

Pjesëmarrësit	Mënyra e llogaritjes	llo
Banka E	$0.470 \times \frac{6}{100} \times \frac{7}{365}$	
Banka A	$0.285 \times \frac{6.15}{100} \times \frac{7}{365}$	
Banka C	$0.250 \times \frac{6.2}{100} \times \frac{7}{365}$	
Banka B	$0.600 \times \frac{6.3}{100} \times \frac{7}{365}$	
Banka D	$10.395 \times \frac{6.49}{100} \times \frac{7}{365}$	1:

Hapi i parë i marrëveshjes përfundon ditën e parë me investimin.

2- Në fund të afatit të maturimit bankat rishesin letrat me vlerë (bonot e thesarit) dhe në këtë moment ato marrin vlerën fillestare të investimit dhe interesin e llogaritur si më lart. Hapi i dytë përfundon pas shtatë ditësh.

1.2. TRANSAKSIONET E SHIT/BLERJEVE ME TË DREJTA TË PLOTA



Fig. 9 Shitblerjet e letrave me vlerë

- **Të përgjithshme**

E veçanta e operacioneve të shitblerjeve me të drejta të plota qëndron në efektin e përhershëm të tyre në tregun e parasë. Këto nuk janë transaksione të kthyeshme. Shitja apo blerja e letrave me vlerë nuk shoqërohet me operacionin e anasjelltë të riblerjes apo rishitjes së tyre. Këto operacione ekzekutohen me iniciativën e Bankës së Shqipërisë dhe kanë për qëllim administrimin e likuiditeteve dhe të normave të interesit. Transaksionet mund të jenë në formën blerjeve të letrave me vlerë, që do të thotë shtim i likuiditetit në sistemin bankar ose rritje e parasë në qarkullim, ose të shitjeve të letrave me vlerë nga Banka e Shqipërisë, që nënkupton tërheqjen e likuiditetit nga sistemi bankar apo zvogëlimin e parasë në qarkullim.

- **Objekti i transaksioneve**

Në transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota mund të shiten dhe të blihen bono thesari me afat fillestar maturimi 3, 6 dhe 12 muaj.

Shit/blerjet me të drejta të plota mund të realizohen nëpërmjet procedurave dypalëshe ose ankandeve të shpejta. Në rastin e kryerjes së transaksioneve të shitblerjeve me të drejta të plota me procedura dypalëshe, Banka e Shqipërisë njofton me SWIFT, faks, teleks apo REUTERS bankën e nivelit të dytë me të cilën synon të veprojë. Nëse kjo bankë pranon të marrë pjesë në transaksion, ajo dërgon menjëherë konfirmim në Bankën e Shqipërisë. Pas këtij veprimi, të dyja palët përcaktojnë kushtet me të cilat do të zhvillohet transaksioni.

Procedura e njoftimit dhe përmbajtja e tij është njësoj si në ankandet e tipit standard. Në këtë rast ndryshon vetëm koha dërgimit të kërkesave të bankave dhe e zhvillimit të ankandit. Në një interval kohe prej dy orësh nga momenti i njoftimit, bankat e nivelit të dytë duhet të konfirmojnë pranë Bankës së Shqipërisë pjesëmarrjen e tyre në ankand. Më tej, vazhdon procedura e ankandit dhe zgjidhen fituesit e tij. Fitues në ankand konsiderohen të gjithë pjesëmarrësit deri në plotësimin e vlerës nominale të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Në rastin e pjesëmarrësve me kushte të njëjta, kërkesat plotësohen pjesërisht sipas mekanizmit *pro-rata*.

Menjëherë pas përfundimit të ankandit, komisioni përkatës përgatit dhe u dërgon pjesëmarrësve njoftimet mbi rezultatet e ankandit.

Shembull. *Operacionet me të drejta të plota.*

Supozojmë se Banka e Shqipërisë njofton me SWIFT, REUTERS, teleks e faks bankat tregtare për ankand shitjeje me të drejta të plota. Bonos së thesarit prej 4 mld lekë që Banka e Shqipërisë ofron për shitje i kanë mbetur 65 ditë deri në maturim.

Njoftimit të Bankës së Shqipërisë i janë përgjigjur banka A dhe banka B si më poshtë:

Bankat	Shuma e kërkuar në lekë	Yield
Banka A	4,000,000,000	
Banka B	15,000,000	
Totali	4,015,000,000	

Nga ankandi del fituese vetëm banka A, pasi ajo ofron çmimin më të lartë për blerjen e bonos së thesarit. Me normën 7.3% çmimi i bonos me vlerë 4 mld llogaritet 3.949 mld lekë, ndërsa me 7.6% çmimi llogaritet 3,947 mld lekë.

Çmimi llogaritet me formulën:

$$\text{Çmimi} = \frac{\text{Vlera Nominale}}{\frac{1 + \text{Yieldi} \times \text{ditët në maturim}}{100 \times 365}}$$

Kështu, banka A duke blerë bonon e thesarit me 3.949 mld lekë, kalon në pronësi të saj bonon e shitur nga Banka e Shqipërisë.

Banka A, duke e patur në pronësi këtë bono, edhe mund ta shesë më tej këtë bono nëse dëshiron.

1.3. OPERACIONET NË VALUTË, NDËRHYRJET



Fig. 10 Operacionet në valutë

Banka e Shqipërisë ndërmerr operacione shitblerjeje me të drejta të plota apo të përkohshme në valutë.

Praktikisht, Banka e Shqipërisë blen dhe shet valutë në treg kur ajo synon të shesë e të blejë në treg kryesisht për të zbutur luhatjet spekulative e të menjëhershme të kursit të këmbimit. Në marrëdhëniet e saj me Qeverinë, Banka e Shqipërisë konverton huatë në valutë në monedhë shqiptare ose i shet valutë Qeverisë për të shlyer detyrimet valutore të borxhit të jashtëm.

2. INSTRUMENTET MBËSHTETËS

Instrumentet mbështetës kanë për qëllim të shtojnë apo të pakësojnë në mënyrë të përkohshme likuiditetin, të sinjalizojnë karakterin e politikës monetare dhe të pengojnë luhatjet e mëdha të normave të interesit. Instrumentet mbështetës realizohen gjithmonë dhe ekskluzivisht me nismën e bankave të nivelit të dytë.

Palë e Bankës së Shqipërisë në këto transaksione janë vetëm bankat e nivelit të dytë.



Fig.11 Porta dhe dritarja e mundësive

2.1. KREDIA LOMBARD

- Të përgjithshme

Kredia lombard përfaqëson një hua të garantuar me letra me vlerë që Banka e Shqipërisë u akordon bankave të nivelit të dytë.

Qëllimi i kredisë Lombard nuk është të ndikojë gjendjen e përgjithshme të likuiditetit në sistemin bankar, por të ndihmojë bankat e nivelit të dytë të kapërcejnë problemet e përkohshme të likuiditetit. Norma e interesit të kësaj kredie, e cila përfaqëson normën më të lartë të interesit të vendosur nga Banka e Shqipërisë, shërben si udhëtrëguese për normat e tjera afatshkurtra të interesit.



Fig. 12 Bankat drejtohen në Bankën e Shqipërisë

Çdo bankë e nivelit të dytë mund të paraqesë pranë Bankës së Shqipërisë kërkesën për kredi Lombard vetëm pasi të ketë shfrytëzuar më parë mundësitë e brendshme të saj për likuiditete, tregun ndërbankar apo dhe marrëveshjet e riblerjes.

Afati i maturimit të kredisë Lombard është deri në tre muaj. Një bankë e nivelit të dytë mund të marrë kredi Lombard vetëm një herë në çdo tremuaj.

Një bankë e nivelit të dytë që paraqet kërkesë për kredi Lombard në Bankën e Shqipërisë, përfiton kredinë Lombard deri në shumën më të madhe midis 20 për qind të kapitalit të paguar të saj dhe 2 për qind të depozitave në lekë.

- Norma e interesit

Norma e interesit të kredisë Lombard është 6 pikë përqindjeje më e lartë se interesi i marrëveshjeve të riblerjeve. Aktualisht, interesi i kredisë Lombard është 13 për qind.

Si mjet për garantimin e detyrimit në rastin e kredisë Lombard shërbejnë bonot e thesarit me afat maturimi 3, 6 dhe 12 mujor.

Në rast se bankat nuk i respektojnë kushtet e rëna dakord mbi to aplikohen dhe masa disiplinore. P.sh. nëse banka e nivelit të dytë nuk e kthen kredinë Lombard në datën e maturimit të saj, atëherë asaj nuk do t'i lejohet të marrë asnjë lloj tjetër kredie në tremujorin pasardhës.

Shembull. Kredia Lombard.

Supozojmë se banka tregtare A, pasi bën parashikimin e arkëtimeve dhe pagesave për gjithë javën vëren se i duhen edhe 500 milionë lekë për të përmbushur gjithë detyrimet e saj.

Banka A kontakton me bankat e tjera tregtare të sistemit, por asnjë nga ato nuk është e gatshme t'i ofrojë likuiditete për shtatë ditë siç kërkon ajo. Kështu, ajo konsideron mundësinë e një kredie shtatë ditore nga Banka e Shqipërisë. Në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë [www.bankofalbania.org] ajo vëren se norma e interesit të kredisë lombard është 13 për qind. Megjithëse kjo kredi është relativisht e shtrenjtë, banka A ka nevoja të menjëhershme dhe është e detyruar ta marrë. Ajo i drejtohet Bankës së Shqipërisë. Në të njëjtën ditë asaj i kalon në llogarinë e saj shuma prej 500 milionë lekë dhe i bllokohen për garantimin e kredisë bonot e thesarit që ajo ka në portofol prej 500 mil lekë.

Për këtë shumë huaje, interesi i llogaritur që duhet t'i paguhet Bankës së Shqipërisë është:

Interesi =

$$\text{Shuma fillestare e investimit} \times \frac{\text{Norma e interesit}}{100} \times \frac{\text{Ditët në maturim}}{365}$$

$$500 \text{ mil} \times \frac{13}{100} \times \frac{7}{365} = 1,246,575.34 \text{ lekë}$$

Pas shtatë ditësh banka A i paguan Bankës së Shqipërisë huanë e marrë prej 500 mil lekë dhe interesin prej 1,246,575.34 lekë.

2.2 KREDIA NJËDITORE



Fig. 13 Banka e Shqipërisë jep kredi për bankat

- *Të përgjithshme*

Kredia njëditore është një kredi plotësisht e garantuar, që akordohet për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë të zgjidhin problemet njëditore të likuiditetit. Gjithashtu, ajo ndihmon për të zbutur luhatjet e normave të interesit afatshkurtër. Banka e nivelit të dytë, që për arsye të ndryshme nuk ka likuiditet të nevojshëm për të përmbushur të gjitha premtimet për pagesa në një ditë të caktuar pune, kërkon në Bankën e Shqipërisë akordimin e një kredie njëditore.

Kredia njëditore mund të akordohet dhe automatikisht nga Banka e Shqipërisë, në rast se llogaria “Rezervë” e një banke të nivelit të dytë deri në orën 15:00 të ditës së punës rezulton nën nivelin e lejuar të saj.

Një bankë e nivelit të dytë mund të kërkojë kredi njëditore pa kufizim, me kushtin që shuma e kërkuar të jetë plotësisht e garantuar me letra me vlerë. Kjo do të thotë që, shuma e letrave me vlerë në portofolin e bankës së nivelit të dytë duhet të jetë e barabartë me shumën e kredisë që ajo kërkon.

- Norma e interesit

Norma e interesit të kredisë njëditore është 2.5 për qind më e lartë se norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes. Aktualisht, norma e interesit e kredisë njëditore është 9.5 për qind (7 për qind norma e repove⁴ plus 2.5 për qind). Norma e interesit përfaqëson atë interes që banka e nivelit të dytë duhet t’i paguajë Bankës së Shqipërisë për huanë e marrë për një ditë. Për të garantuar kredinë njëditore shërbejnë bonot e thesarit me afat maturimi 3, 6 dhe 12 mujor.

Shembull. Kredia njëditore.

Supozojmë se banka tregtare A, pasi bën parashikimin e arkëtimeve dhe pagesave të ditës, vëren se i duhen edhe 750 milionë lekë për të përmbushur gjithë detyrimet e saj për ditën.

⁴ Repo është shkurtimi në anglisht i termit “Marrëveshje Riblerje” (Repurchase Agreement).

Gjithashtu, ajo parashikon se të nesërmen arkëtimet e saj, do të jenë rreth 1 miliardë lekë më të larta se pagesat dhe fondet në arkë do të jenë të mjaftueshme për të shlyer një hua prej 750 milionë lekë që ajo dëshiron të marrë sot. Banka A kontakton me bankat e tjera tregtare të sistemit, por partnerët që ajo gjen nuk përbushin kërkesat e saj si për afatin e kredisë ashtu dhe për normën e interesit. Në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë [[www. bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)] ajo sheh normat e interesit të publikuara prej saj dhe vëren se norma e interesit të kredisë njëditore është 9.5 për qind. Meqë kjo gjë i duket e përshtatshme, ajo i drejtohet Bankës së Shqipërisë për një kredi njëditore prej 750 milionë lekë. Në po të njëjtën ditë që bën kërkesën bankës i kalojnë në llogarinë e saj fondet prej 750 milionë lekë.

Për këtë shumë huaje, interesi i llogaritur që duhet t'i paguhet Bankës së Shqipërisë është:

Interesi =

$$\text{Shuma fillestare e investimit} \times \frac{\text{Norma e interesit}}{100} \times \frac{\text{Ditët në maturim}}{365}$$

$$750\text{mil} \times \frac{9.5}{100} \times \frac{1}{365} = 195,205.4$$

Të nesërmen banka A i paguan Bankës së Shqipërisë huanë e marrë prej 750 mil lekë dhe interesin prej 195,205.4 lekë.

2.3. DEPOZITAT NJËDITORE



Fig. 14 Bankat depozitojnë në Bankën e Shqipërisë

- Të përgjithshme

Depozita njëditore përfaqëson një instrument që ndihmon bankat e nivelit të dytë të veprojnë me likuiditetin e tepërt, duke e depozituar atë vetëm për një ditë në Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, depozita njëditore ndihmon në tërheqjen e likuiditetit të tepërt nga sistemi bankar dhe në zbutjen e luhatjeve të mëdha në normat afatshkurtra⁵ të interesit. Interesi mbi depozitën njëditore përfaqëson normën më të ulët të interesit në treg. Shuma e fondeve në lekë që banka e nivelit të dytë dëshiron të vendosë në depozitë njëditore pranë Bankës së Shqipërisë është e pakufizuar. Megjithatë, Banka e Shqipërisë mund të refuzojë kërkesën e bankave të nivelit të dytë për të vendosur depozitë njëditore pa dhënë shpjegime. Refuzimi i kërkesës nga Banka e Shqipërisë bëhet në varësi të kushteve të tregut, të programit monetar dhe të objektivave afatshkurtra në lidhje me normat e interesit në treg.

⁵ Norma afatshkurtra nënkupton normat e interesit për çdo alternativë investimi për afatet e maturimit 3, 6 dhe 12 mujore.

- **Norma e interesit**

Norma e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan bankës së nivelit të dytë është 2.5 për qind, me bazë vjetore, më e ulët se norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjeve. Kështu, nëse norma e marrëveshjeve të riblerjes është 7 për qind, norma e interesit të depozitës është 4.5 për qind (7 për qind norma e *repove*, zvogëluar me 2.5 për qind).

Shembull. *Depozita njëditore.*

Supozojmë se banka E gjatë një dite të caktuar ka patur hyrje mjaft të larta në arkën e saj. Pasi ka përfunduar gjithë veprimet e pagesave në emër të klientëve të saj dhe pasi ka investuar një pjesë të fondeve në tregun primar të bonove të thesarit, ajo vëren se ka ende të lira në llogarinë e saj rreth 500 mil lekë. Megjithatë, për ditën e nesërme ajo ka parashikuar të ketë dalje nga arka dhe fondet që i ka të lira sot, i duhen domosdoshmërisht për nesër. Së pari, ajo mendon që t'i investojë këto para në tregun ndërbankar vetëm për një ditë. Pasi kontakton me disa nga bankat e tjera të sistemit, ajo vëren se asnjëra nga këto banka nuk ka nevoja për likuiditete dhe asnjëra nuk është e gatshme (me kushtet e bankës E) të hyjnë në transaksion me të. Kështu që, banka E mendon t'i vendosë në depozitë njëditore pranë Bankës së Shqipërisë fondet që i ka të lira sot. Interesi që merr banka E nga Banka e Shqipërisë është 4 për qind. Ai llogaritet:

Interesi =

$$\text{Shuma në depozitë} \times \frac{\text{Norma e interesit}}{100} \times \frac{\text{Ditët në maturim}}{365}$$

$$500 \text{ mil} \times \frac{4.5}{100} \times \frac{1}{365} = 61,643.8$$

Kështu, ditën e nesërme, bankës E do t'i kalojnë në llogarinë e saj 500 mil lekë që i kishte në depozitë dhe interesi prej 61,643.8 lekë.

3. REZERVA E DETYRUESHME




Fig. 15 Rezerva e detyrueshme mbahet në llogaritë e bankave pranë Bankës së Shqipërisë

- Të përgjithshme

Rezerva e detyrueshme përfaqëson atë pjesë të fondeve që bankat e nivelit të dytë duhet të mbajnë në llogarinë e tyre pranë Bankës së Shqipërisë, në lekë dhe në valutë..

Norma e rezervës së detyrueshme mbi depozitat në lekë dhe në valutë është e njëjlojtë, 10 për qind, për të gjitha elementet e bazës së rezervës. Shuma e rezervës së detyrueshme që mbahet në llogarinë e bankave të nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë është e shpërblyeshme. Kjo do të thotë që, bankat e nivelit të dytë marrin interes për fondet e lëna si rezervë e detyrueshme në Bankën e Shqipërisë. Rezerva e detyrueshme realizon funksionet monetare të mëposhtme:

▪ *Stabilizimin e normave të interesit në treg*

Mekanizmi i zbatimit të rezervës së detyrueshme synon të kontribuojë në stabilizimin e normave të interesit në treg, duke i dhënë bankave të nivelit të dytë mundësi dhe njëkohësisht lehtësi për të zbutur apo për të sheshuar efektet e luhatjeve të përkohshme në gjendjen e likuiditetit të tyre. Thënë më qartë, bankat e nivelit të dytë mund të përdorin fonde nga llogaria e rezervës së detyrueshme për kryerjen e transaksioneve të përditshme, me kusht që mesatarja javore e llogarisë rezervë të jetë jo më e vogël se rezerva e detyrueshme e muajit.

▪ *Krijimin apo rritjen e mungesave të likuiditetit*

Rezerva e detyrueshme kontribuon në krijimin apo rritjen e mungesave të likuiditetit. Kjo është e dobishme me qëllim që të përmiresohet aftësia e Bankës së Shqipërisë për të operuar me eficiencë në rolin e saj si furnizues likuiditetesh. Kështu, ulja e normës së rezervës së detyrueshme mund të çojë në rritjen e parasë në qarkullim, duke bërë që në arkat e bankave dhe duart e publikut të jenë më shumë fonde që më parë kanë qenë të vendosura si rezerva. Ndërsa, rritja e normës së rezervës së detyrueshme do të thotë, më shumë para të bllokuara në formën e rezervës së detyrueshme dhe më pak para në qarkullim.

- **Përcaktimi i rezervës minimale të detyrueshme**

a. Baza e rezervës

Bankat detyrohen të mbajnë rezervë mbi depozitat monetare në lekë dhe në valutë, ose thënë ndryshe, mbi detyrimet e tyre ndaj klientëve. Rezerva e detyrueshme llogaritet mbi depozitat monetare në lekë dhe në valutë, duke përfshirë letrat me vlerë të emetuara nga bankat dhe duke përjashtuar depozitat dhe llogaritë rrjedhëse që kanë bankat me njëra-tjetrën si dhe fondet e krijuara për garantimin e letërkredive.

Bankat e nivelit të dytë raportojnë çdo javë në Bankën e Shqipërisë të dhënat për llogaritjen e rezervës së detyrueshme, sipas formularëve përkatës. Baza e rezervës për muajin M-1 përcaktohet në muajin M sipas të dhënave të dërguara për depozitat në lekë dhe në valutë. P.sh. baza e rezervës për muajin janar përcaktohet në muajin shkurt.

b. Llogaritja e rezervës minimale të detyrueshme



Fig. 16 Llogaritja e rezervës së detyrueshme

Rezerva minimale e detyrueshme për çdo bankë të nivelit të dytë llogaritet duke zbatuar mbi bazën e rezervës normën e rezervës së detyrueshme. Norma e rezervës së detyrueshme është uniforme për gjithë llojet e depozitave që përbëjnë bazën e rezervës (lekë dhe valutë) në nivelin 10 për qind. Rezerva e detyrueshme në lekë dhe në valutë llogaritet në bazë të informacioneve javore.

- **Mbajtja e rezervës së detyrueshme**

a. Periudha e mbajtjes së rezervës minimale të detyrueshme

Periudha e mbajtjes së rezervës së detyrueshme është një muaj. Mbajtja fillon nga dita e pesëmbëdhjetë e muajit M deri në ditën e katermbëdhjetë të muajit M+1, për llogari të muajit M-1.

P.sh: rezerva e detyrueshme për muajin janar paguhet në datën 15 shkurt dhe mbahet nga data 15 shkurt deri në datën 14 mars.

b. Mbajtjet e rezervës

Bankat e nivelit të dytë mbajnë në Bankën e Shqipërisë llogari në lekë dhe në valutë. Llogaria në lekë emërtohet llogaria “Rezervë” dhe përbëhet nga llogaria rrjedhëse dhe rezerva e detyrueshme. Bankat gjatë ditës mund të përdorin deri në 5 për qind të llogarisë së rezervës së detyrueshme, por duhet që brenda javës ta zëvendësojnë këtë përdorim, me kusht që mesatarja javore e llogarisë

“Rezervë” të jetë sa rezerva e detyrueshme në lekë e llogaritur nga Banka e Shqipërisë në datën 15 të muajit përkatës.

Për rezervën e detyrueshme në valutë, bankat kanë llogaritë “rezervë e detyrueshme” në dollarë amerikanë dhe EURO, të cilat furnizohen nga llogaritë rrjedhese të bankave të nivelit të dytë në Bankën e Shqipërisë në dollarë amerikanë dhe EURO.

c. Remunerimi i rezervës minimale të detyrueshme



Fig. 17 Llogaritja e remunerimit të rezervës së detyrueshme në Bankën e Shqipërisë

Për rezervat e detyrueshme të bankave të nivelit të dytë, që mbahen pranë Bankës së Shqipërisë, kjo e fundit paguan interesa, pra i remuneron ato.

Për rezervën e detyrueshme në lekë, norma e remunerimit është sa $1/2$ e *yield*-it të bonove të thesarit me maturim tre-mujor në ankandin më të fundit para datës 15 të çdo muaji kur fillon mbajtja e rezervës së detyrueshme.

Për rezervën e detyrueshme në valutë, norma e remunerimit është sa $1/2$ e interesit LIBOR⁶ për depozitat me afat njëmuajor në dollarë amerikanë dhe në EURO, në datën 15 të muajit kur fillon mbajtja e rezervës së detyrueshme. P.sh: në datën 15 shkurt fillon mbajtja e rezervave të detyrueshme për muajin janar dhe paguhen remunerimi për rezervat e detyrueshme të muajit dhjetor, që janë mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga data 15 janar deri në 14 shkurt.

- **Mospajtimi me detyrimet për mbajtjen e rezervës minimale të detyrueshme**




Fig. 18 Ç' duhet bërë?

Çdo bankë nivelit të dytë mund të gjendet në kushtet e mosplotësimit të rezervës së detyrueshme. Banka ka mosplotësim të rezervës së detyrueshme kur:

- pas llogaritjes së rezervës së detyrueshme, banka nuk ka gjendjen e nevojshme në llogarinë e saj në valutë për plotësimin e rezervës së detyrueshme në valutë.
- Në periudhën e mbajtjes së rezervës së detyrueshme në lekë, gjatë javës, mesatarja javore e rezervës së detyrueshme të bankës së nivelit të dytë është nën nivelin rezervës së

⁶ LIBOR - London InterBank Offered Rate - norma e interesit e ofruar në tregun ndërbankar Londinez.

detyrueshme, që është llogaritur dhe përcaktuar në datën 15 të muajit përkatës (niveli 100 për qind). Me qëllim që bankat e nivelit të dytë të administrojnë më mirë likuiditetet e tyre, në rastet e mosplotësimit të rezervës së detyrueshme, Banka e Shqipërisë zbaton këto gjopa:

- për mosplotësim të rezervës së detyrueshme në lekë, masa e gjobës llogaritet për çdo ditë mosplotësimi, me interesin e ankandit më të fundit për bonot e thesarit me afat maturimi tremujor, plus 2 për qind,



Fig. 19 Pagimi i gjobës në lekë

- për mosplotësim të rezervës së detyrueshme në dollarë amerikanë dhe EURO, masa e gjobës llogaritet, në dollarë amerikane, për çdo ditë mosplotësimi me interesin LIBOR për depozitat tremujore në dollarë amerikanë të ditës së fundit të muajit për të cilin llogaritet rezerva e detyrueshme, plus 2 për qind.



Fig. 20 Pagimi i gjobës në valutë